

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta e procedurës penale e krahasuar
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	2021/22
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	E premte 15.00 – 16.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Azem Hajdari
Detajet kontaktuese:	Viti I
Përshkrimi i lëndës	<p>E drejta e procedurës penale e krahasuar është pjesë e shkencës juridike penale e cila luan rol të madh në avancimin e zgjidhjeve ligjore për çështjet me natyrë procedurale penale dhe në avancimin e mendimit shkencor për çështje të tilla.. Në bazë të plan-programit mësimor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, lënda- E drejta e procedurës penale e krahasuar, si lëndë zgjedhore fakultative në vitin akademik 2019/20, e cila ligjërohet në semestrin e parë të programit Master, Drejtimit Juridik Penal, përfshinë njësitet e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e misionit të saj, njohjen me të drejtat e procedurës penale të shteteve të ndryshme, dhe avancimin e mendimit shkencor brenda vendit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga e drejta e procedurës penale e Kosovës, por edhe të disa shteteve të tjera, e cila si pjesë e shkencës juridiko- penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. Programi mësimor nga lënda e drejta e procedurës penale e krahasuar, do të shtjellohet në aspektin teorik, por edhe atë praktik (nëpërmjet ligjëratave, përpilimin e shkresave proceduralo-penale, seminareve, debateve dhe diskutimeve me studentë). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studentëve me njohuri shkencore nga lëmi i procedurës penale, të atilla që kalojnë dimensionin e shkencës vendore. Kështu, studentët do të aftësohen që si jurist të ardhshëm me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme me natyrë proceduralo- penale, të</p>

	<p>përpilojnë me lehtësi shkresat proceduralo- penale, të adresojnë drejtë çështjet që lidhen me kompetencat e organeve të procedurës penale dhe kështu t'i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit, gjithnjë duke marrë për bazë edhe modelet e më shumë shteteve bashkëkohore.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Me trajtimin e njësisve të caktuara të së drejtës së procedurës penale të krahasuar, studentëve u ofrohet materia përkatëse që të kuptojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe përmbajtjet kryesore shkencore. Vëzhgimi i aktiviteteve të studentëve dhe debatet e zhvilluara në këtë fushë, me trajtimin e rasteve konkrete nga praktika e organeve proceduralo- penalet vendeve të ndryshme, ka për qëllim aftësimin e studentëve në lëmin e kësaj shkence. Në sistemin e mësimit zbatohen metodat e shtjellimit të lëndës ashtu që organizohen debate, teste, seminare e kolokviume me qëllim të nxitjes së punës aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Me këto metoda mësimore, studenti që kryen fakultetin juridik, Programin Master, Drejtimin Juridik Penal aftësohet me njohuri themelore rreth mënyrës së veprimit të gjykatave dhe organeve tjera të procedurës penale të disa vendeve në zgjidhjen e drejtë të çështjeve penale. Vlerësimi i studentit gjatë kohës së ligjëratave bëhet edhe me testim. Kështu që një herë gjatë semestrit organizohet testi i vlerësimit dhe verifikimit të dijeve të fituara.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dallojë qartë përparësitë dhe mangësitë e zgjidhjeve ligjore procedurale penale të disa shteteve. 2. Të njihet me aktet ndryshme ndërkombëtare që prekin çështje procedurale penale dhe modelet e zgjidhjeve që ato ofrojnë. 3. Të njihet me zgjidhjet e çështjeve penale nga gjykatat e vendeve të ndryshme. 4. Të hartojë shkresa të ndryshme me natyrë proceduralo- penale, 5. Të kualifikojë sipas rëndësisë që kanë për zgjidhjen e drejtë të një çështje penale provat, e kështu me radhë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	1	5	05
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	05
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	5	5	25
Detyra të shtëpisë	5	5	25
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	10	10
Projektet,prezentimet ,etj	1	10	10
Totali	21	98	183
Metodologjia e mësimdhënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në pjesën më të madhe të kohës do të mbahen ligjërata interaktive, që do me thënë, që përveç ligjërimit të mësimdhënësit, kyçen edhe studentët duke u pyetur, diskutuar, këmbyer mendimet mbi çështjet tematike që janë objekt i ligjëratisë. 2. Punimet seminarike përcaktohen sipas zgjedhjes së studentit. Atyre u ofrohen udhëzime se si duhet përgatitur seminarët. Pastaj bëhet dorëzimi i punimit seminarik, mësimdhënësi e kontrollon atë, pastaj në orët e caktuara mësimore, lexohet nga studenti dhe hapet diskutimi lidhur me to. 3. Ushtrime në përgatitjen e një çështje penale konkrete. Simulohet rasti i caktuar, studentëve u shtrohet detyra që të përgatisin një ankesë apo aktgjykim, e pastaj hapet diskutimi dhe komentohet çështja. 		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes zbatimit të këtyre metodave:		

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kolokviumeve, 2. Prezantimeve, 3. Punimeve seminarike, 4. Pjesëmarrjes në debate etj.
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Altin Shegani, E drejta penale e krahasuar, Tiranë, 1999.</p> <p>Ejup Sahiti, Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2007.</p> <p>Hajdari A., E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.</p> <p>Sahiti E. dhe Murati R., E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2014.</p> <p>Hajdari A., E drejta e procedurës penale e të miturve, Prishtinë, 2005.</p>
Literatura shtesë:	<p>Samaha J., Criminal procedure, Boston, 2014,</p> <p>Rolando V. Criminal Procedure: Laë and Practice, Neë York, 2016,</p> <p>Sëanson Ch. Criminal Investigation, London, 2014,</p> <p>Fausto I. E drejta procedurale penale, Përkthim, Tiranë, 2002. Grigor Gj. Procedura penale e RPSH, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970,</p> <p>Grubač M. Krivično procesno pravo, Posebni deo, Beograd, 2004,</p> <p>Hajdari A. Komentar- Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016,</p> <p>Hajdari A. E drejta e procedurës penale- Komentar, Prishtinë, 2010.</p> <p>Islami H. etj. Procedura penale, Tiranë, 2003,</p> <p>Matovski N. Kazнено procesno pravo, Skopje, 2004,</p> <p>Nova K. Proçedura penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966,</p> <p>Panta M. Komentarot na zakonot za krivičnata postopka, Skopje, 1979,</p> <p>Pavišić B. etj. Zakon o kaznenom postupku, Zagreb, 1998,</p> <p>Sahiti E. Murati R., Elshani Xh., Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014,</p> <p>Sierčić Č. Krivično procesno pravo, Sarajevo, 2005</p> <p>Stevanović Č i dru. Krivično posebno pravo, Beograd, 1997,</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nocioni i të drejtës së procedurës penale të krahasuar 2. Studimi i dallimeve dhe ngjashmërive ndërmjet dy ose më shumë sistemeve juridike penale 3. Karakteristikat e të drejtës së procedurës penale të krahasuar 4. Krahasimi i sistemeve procedurale penale 5. Tendenca për efikasitet procedural penal dhe të drejtat e njeriut
Java e dytë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi historik i të drejtës së procedurës penale të krahasuar 2. Vështrim krahasues i tipave të procedurës penale
Java e tretë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i të drejtës së procedurës penale të krahasuar me shkencat tjera 2. Burimet e së drejtës së procedurës penale të krahasuar
Java e katërt:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Metodat e të drejtës së procedurës penale të krahasuar 2. Instrumentet e krahasimit
Java e pestë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi i procedurës penale në planin krahasues 2. Organet e procedurës penale
Java e gjashtë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i procedurës penale 2. Juridiksionet: juridiksioni i hetimit dhe gjykimit 3. Përbërja e juridiksioneve
Java e shtatë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Instanca, kuptimi 2. Ndjekja penale 3. Prova, kuptimi dhe administrimi i provës 4. Komunikimi i provës
Java e tetë:	Sistemi francez i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e nëntë:	Sistemi belg i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e dhjetë:	Sistemi gjerman i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemi anglez i drejtësisë penale, pjesa procedurale Kolokvium
Java e dymbëdhjetë:	Sistemi italian i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e trembëdhjetë:	Sistemi holandez i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e katërbëdhjetë:	Sistemi spanjoll i drejtësisë penale, pjesa procedurale
Java e pesëmbëdhjetë:	Sistemi portugez i drejtësisë penale, pjesa procedurale

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Përmes punës me student do të arrihet në:

1. Avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës,
2. Avancojë zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;

3. Ndhimohet në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
4. Krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe kërkimeve shkencore;
5. Zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe kreativ etj.